

## Zhvillohet Takimi i Mjekësisë në Diasporë



Është zhvilluar Takimi i Mjekësisë në Diasporë, një takim i veçantë dedikuar profesionistëve në fushën e mjekësisë, përfshirë mjekë shqiptarë me veprimtari profesionale në Diasporë dhe mjekë nga Diaspora që janë rikthyer në vendin e origjinës. Ky takim zhvillohet për herë të parë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko në fjalën përshëndetëse falenderoi pjesëmarrësit për prezencën e tyre në takim duke theksuar rëndësinë që ka Diaspora shkencore në zhvillimin e vendit. "Anëtarët e Diasporës vazhdojnë të kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale jo vetëm me rikthimin e tyre në Shqipëri, por edhe përmes "kthimit virtual". Bashkëpunimi me kolegët e tyre në vendin e origjinës krijon një sinergjí profesionale e institucionale me rrjetet dhe shoqatat e profesionistëve në vendet e Bashkimit Europian, ShBA, e vende të tjera të zhvilluara", u shpreh ministri Majko. Këtë aktivitet me rëndësi të veçantë e përshëndeti edhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu, e cila e vlerësoi rikthimin e disa prej mjekëve në Shqipëri për të kontribuar në vendin e tyre me patriotizëm dhe sakrificë. "Janë modelet më të mira që na bëjnë krenar dhe ne duhet të vijmë me një paketë mbështetjeje për rikthimin e mjekëve në Shqipëri", u shpreh ministria. Gjithashtu, dy personalitete të njohuara të fushës së mjekësisë, Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Prof. Dr. Arben Gjata dhe Presidenti i Urdhrit të Mjekut, Dr. Fatmir Brahimaj përshëndetën këtë takim duke theksuar rëndësinë që ka angazhimi i Diasporës shqiptare në veprimtarinë akademike si mbështetja me zbatimin e projekteve apo në mësimdhënie. Diskutimet po vijojnë me zhvillimin e dy paneleve: "Politikat dhe programet e punësimit në sektorin e shëndetësisë" dhe "Inovacionet në shëndetësinë shqiptare dhe raste suksesi". Këto forma organizimi mund të kanalizojnë më mirë përpjekjet dhe kontributet e Diasporës shqiptare për zhvillimin e vendit.

## Panelet e Takimit të Mjekësisë në Diasporë




Pjesa e dytë e takimit u zhvillua në dy panele: "Politikat dhe programet e punësimit në sektorin e shëndetësisë" dhe "Inovacionet në shëndetësinë shqiptare dhe raste suksesi". Diskutimet gjatë paneleve u përqëndruan kryesisht në politikat shëndetësore, programet e punësimit dhe zhvillimet e fundit në sektorin e shëndetësisë shqiptare. Gjithashtu, pjesëmarrësit mjekë nga Diaspora, të cilët ushtrjnë profesionin e tyre jashtë Shqipërisë, si edhe mjekë shqiptarë të rikthyer në vend pasi kanë ndërtuar eksperiencën e tyre profesionale jashtë vendit, patën mundësinë të ndërveprojnë me kolegët e tyre në Shqipëri. Disa prej mjekëve pjesëmarrës janë kthyer dhe kanë rihyrë në sistemin shëndetësor publik, disa të tjerë kanë krijuar shërbime private; të gjithë këta kanë një rol të rëndësishëm për Shqipërinë dhe sistemin shëndetësor në vend.

## Takimi i Shkrimtarëve të Diasporës

Qendra e Botimeve për Diasporën organizon Takimin e Shkrimtarëve nga Diaspora "Letra nga Diaspora" më 22 shkurt në Tiranë. Ky takim do të ndihmojë në njohjen, promovimin dhe krijimin e komunikimit të shkrimtarëve të Diasporës me lexuesit dhe botuesit shqiptarë dhe synon prezantimin e letërsisë së Diasporës, duke u kthyer në një traditë vjetore dhe në një zëdhënës të rëndësishëm të letërsisë së migracionit shqiptar.



## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

## "Raporto" problemat në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

## Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



## Shpallen vendet e lira të punës në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët



Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka firmosur urdhrin nr. 38, datë 18.2.2020, "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Qendrës e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët" dhe shpalljen e vendeve të lira të punës pranë QSPA-së, si dhe ngritjen e komisionit përgjegjës për rekrutimin e personelit. Ky urdhrë është lëshuar në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

## Zhvillohet seanca dëgjimore në nënkomisionin "Për Diasporën dhe Migracionin"



Në nënkomisionin "Për Diasporën dhe Migracionin" u zhvillua seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe drejtoreshave ekzekutive: znj. Mimoza Hysa nga Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD), znj. Elona Bano nga Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD) si dhe znj. Blerina Turdu nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD). Gjatë kësaj seance, ministri Majko prezantoi reformat e ndërmara deri më tani dhe strukturën shtetërore përgjegjëse të krijuar për Diasporën. Më tej, drejtoreshat e institucioneve njohën anëtarët e këtij nënkomisioni me veprimtarinë e institucioneve përkatëse të realizuar gjatë vitit 2019. Drejtoresha e AKD-së, znj. Bano prezantoi Buletin tremujor për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare si dhe publikime të tjera nga institucioni. Znj. Hysa, drejtoresha e QBD-së, u ndal në nisimin për shpërndarjen e teksteve të mësimi plotësues të gjuhës shqipe në Diasporë. Më tej, Turdu nga FSHZHD-ja theksoi rëndësinë e projekteve në zbatim nga institucioni, duke u ndalur tek krijimi i Domenit së Biznesit të Diasporës Shqiptare me një rëndësi të veçantë për natën e investimeve në Shqipëri. Në përmbyllje të diskutimit u prezantuan dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara për vitin 2020.

## Konferenca Ndërkombëtare Shkencore "Emigracioni Politik Shqiptar në Vitet 1944-1990"



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "Emigracioni Politik Shqiptar në Vitet 1944-1990". Në fjalën e tij, në panelin me temë "Përvoja personale mbi emigracionin politik në Shqipëri", ministri Majko dhe një përmbledhje të historisë së migracionit gjatë asaj periudhe dhe se si migrimi jashtë Shqipërisë ishte një akt i ndaluar me ligj. Më tej, ai tregoi se si Diaspora shqiptare në atë kohë prodhoi autoritetet e veta, të cilët u vendosën pranë përfaqësuesve të diasporës më të vjetër si Falk Konica dhe Fan Noli, dhe kontribuan në lirinë e vendit.

## Në takim me Ambasadorin e SHBA-së në Shqipëri, znj. Yuri Kim



Ministri i Shtetit për Diasporën u takua me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, znj. Yuri Kim, me të cilën pati një diskutim mbi politikat shtetërore të hartuara deri më tani për Diasporën shqiptare.

## "Corriere della Sera" prezanton Takimin e Shkrimtarëve të Diasporës

Gazeta prestigjioze italiane "Corriere della Sera" prezanton Takimin e Shkrimtarëve të Diasporës që organizohet nga Qendra e Botimeve për Diasporën nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Shkrimi bën një paraqitje të plotë dhe të detajuar të programit të eventit duke përmendur pjesëmarrjen e organizatorëve të festivalit italian «Europa/Mediterraneo. Passaggi ad Est» si një mundësi të veçantë për të njohur autorë shqiptarë.



## Nëshkruhet marrëveshja për njohjen e patentave shqiptare në Turqi



Vetëm disa ditë pasi parlamenti grek miratoi njohjen e ndërsjellë të patentave mes Shqipërisë dhe Greqisë, përmes një marrëveshjeje, edhe Turqia do të bëjë të mundur njohjen dhe konvertimin e patentave të të gjithë shtetasve shqiptarë. Kjo marrëveshje u firmos gjatë ditës së sotme dhe do të hyjë në fuqi pas miratimit në parlamentet e të dy vendeve.

## KKD / Mark Gjonaj në ceremoninë e 12- vjetorit të Pavarësisë



Mark Gjonaj, kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe këshilltar i Bashkisë së Nju Jork-ut, mori pjesë në ceremoninë e organizuar për 12-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, në Konsullatën e Kosovës në Nju Jork, SHBA. Në fjalën e tij, z. Gjonaj vlerësoi këtë takim me rëndësi të organizuar nga komuniteti shqiptaro-amerikan për të shënuar Pavarësinë e Kosovës. "Është një kënaqësi për mua të jem i pranishëm në këtë ceremoni të veçantë me komunitetin shqiptaro-amerikan dhe gëzuar 12-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Në këtë aktivitet të rëndësishëm për komunitetin tonë, më lejoni të uroj krijimin e qeverisë së re të Kosovës, shpresojmë të sistemi i ri demokratik dhe fuqia e tyre për të ndërtuar një të ardhme dhe një Kosovë të re", ka thënë Gjonaj.

## KKD / Brikena Muharremi pjesë e disa aktiviteteve kulturore të organizuara me Diasporën shqiptare



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Brikena Muharremi, ka qenë pjesë e disa aktiviteteve kulturore të organizuara me Diasporën shqiptare në Britaninë e Madhe. Një ndër aktivitetet ku ajo ishte pjesëmarrëse është mbledhja e festive e organizuar nga Forumi i Shoqatave Shqiptare në Britaninë e Madhe të Kosovës në 12-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Në fjalën e saj, ajo tha: "Në festojmë një mungëllim që Kosova bën si shtet si rezultat i shumë sakrificave jo vetëm të popullit tonë por edhe të popujve të tjerë që kontribuan për lirinë tonë. Shova se jemi krenarë që tani festojmë të lirë duke dëshmuar vetën si komb i cili ka aq shumë për t'i dhënë botës. Gjithashtu falënderova të gjitha shoqatat në Britani dhe kudo në botë për punën që bëjnë për të promovuar kulturën tonë dhe për të ruajtur identitetin tonë", bëhet e ditur në një deklaratë të saj në rrjetin social "Facebook".

## KKD / Lazim Destan viziton Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës



Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe Presidenti Nderi i Domenit së Biznesit të Kosovës Shqiptare, z. Lazim Destan me rastin e festës së Pavarësisë së Kosovës ka vizituar Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Landin, North Rhine-Westphalia (NRW). Gjatë kësaj vizite bëhet e ditur se z. Destan njohu konsullin Arjan Kashtarjevac me funksionimin e Këshillit Koordinues të Diasporës, rolin e tij si anëtar i Këshillit dhe Domenit së Biznesit të Diasporës Shqiptare, e ngjitur në fund të vitit të kaluar. Përmes një deklaratë në rrjetin social "Facebook", z. Destan i shpreh se: "Ka përfaqësuar konsullate diplomatike do të sjellë lehtësira për diasporën tonë në këtë anë të Gjermanisë duke u ofruar shërbime më të mira e më efektive. Në prirjen që më bëri Konsulli i Përgjithshëm, Arjan Kashtarjevac, fillimisht pata kënaqësi t'ia përjetoi urimet e mia për hapjen e Konsullatës si dhe urimet më të përzemërta për 12-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Me z. Kashtarjevac shkëmbyem mendime e diskutuam rellt bashkëpunimit tonë në të ardhmen, për ta mbështetur diasporën tonë në mbrojtje të interesave të tyre në të gjitha drejtimet. Konsulli Kashtarjevac u shpreh shumë falënderues për vizitën si dhe e cmoi lart gatishmërinë lënë për bashkëpunimin", ka shkruar Destan. Më tej, ai shtoi se Landi NRW është ndër Landet me industri dhe ekonomi të zhvilluar dhe theksuar se janë shumë premtime mundësi e bashkëpunimit ekonomik e tregtar Gjermani-Kosovë duke ndihmuar kështu natën e kapitalit të investitorëve të ndryshëm nga kompanitë gjermane.

## KKD / Endri Hatillari vlerësohet me titullin Ambasador i Paqes nga "Federata e Paqes Botërore"



Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Endri Hatillari ishte i pranishëm në disa aktivitete të zhvilluara në komunitetin shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar. Ai mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga shoqatat dhe shkollat shqiptare për shënimin e 12-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, z. Hatillari është vlerësuar me titullin Ambasador i Paqes nga "Federata e Paqes Botërore". Me rëndësi ishte dhe pjesëmarrja e tij në aktivitetin e organizuar nga Shoqata e Avokatëve Shqiptarë dhe nga Shoqata e Profesionistëve Shqiptarë (UK Albanian Professionals) ku bisedoi dhe për mundësitë e bashkëpunimit dhe promovimin e vlerave të tyre.